



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-19726 dt. 29/05/2025



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, në harmoni me nenin 2 të ligjit nr.03/L-049 për financat e pushtetit lokal, nenit 27 të LMFPP nr. 03/L-048, nenit 9, paragrafi 6 i ligjit nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025. Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.05.2025, miratoi këtë:

**VENDIM
PËR**

BARTJEN E FONDEVE -TE HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2024 NË VITIN 2025

Neni 1

Me këtë vendim, miratohet bartja e mjeteve financiare të bilanceve të pashpenzuara të të hyrave vetanake të vitit paraprak(2024) në vitin 2025.

Neni 2

Të hyrat vetanke për bartje nga bilancet e pashpenzuara janë gjithsej 486,469.62 € përkatësisht, fondi burimor 21 në shumën 359,871.06 € dhe fondi burimor 22 në shumën 126,598.56 €.

Neni 3

Bilancet e pashpenzuara barten ne këto kategori ekonomike te shpenzimeve:

Mallra dhe Shërbime.....9,813.86 €,
Shpenzime Komunale.....74.42 €,
Subvencione dhe Transfere5,447.77 €,
Investime Kapitale.....471,133.57 €.

Neni 4

Shuma e mjeteve për bartje nga bilanci i pashpenzuar i fondit 21 dhe 22

Në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në nën-programët:

Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100),.....3,598.30 €
Arsimi Parashkollor (92210),.....5,964.46 €
Administrata(16301),.....251.10 €

Në kategorinë e shpenzimeve Komunale në nën-programët:

Infrastruktura Rrugore(18001),.....74.42 €

Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere në nën-programët:

Zyra e Kryetarit (16001),.....	3,500.00 €
Administrata (73010),.....	1,622.46 €
Infrastruktura Rrugore(18001),.....	325.31 €

Në kategorinë e shpenzimeve Investime Kapitale:

Nën-programi Infrastruktura Publike (18161) në projektet:

“Rregullimi I trotuareve dhe ndriqimi public Drenas,Komoran,Arlat”,kodi (53635).....	55,851.34 €
“Zgjerimi dhe ndërtimi i Sheshit“ Fehmi e Xhevë Lladrovci” Drenas,kodi (49297).....	865.99 €
“Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas”,kodi(48661).....	92,727.18 €
“Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza Drenas-Dobroshec,kodi (53631).....	110,772.20 €
“Asfaltimi i rrugës në fshatin Abri e Epërme,Terdec,kodi (53670)	39,445.00 €
“Asfaltimi i rrugës Baicë,Krajkovë,Damanek,Shtrubullovcë,kodi(51340)	12,175.70 €
“Asfaltimi i rrugës në fshatin Zabel i Ulët dhe E.,Korroticë e Ulët dhe E.,kodi (48658)	7,052.71 €
“Ndërtimi,zgjerimi dhe rekunstruimi i rrugëve të asfaltuara në Drenas,kodi(53660),	53,777.19 €
“Asfaltimi i rrugëve në fshatin Nekoc dhe Kizhnarekë,kodi(53672)	15,474.72 €

Nën-programi Shërbimet Kulturore (85001) në projektin:

“Fusha sportive dhe rekreacion ne Arrllat dhe Llapushnik”,kodi(54014)	11,385.66 €
---	-------------

Nën-programi Infrastruktura Rrugore (18001) në projektet:

“Rregullimi dhe zgjerimi i vendaljeve për autobus dhe mbulimi,kod(53364).....	20,261.50 €
“Sinjalizimi Vertikal dhe horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve”,kodi(53316)	2,804.00 €
“Zgjerimi i kamerave në Drenas dhe Komoran”,kodi(53341).....	3,818.25 €

Nën-programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66310) në projektin:

“Vendosja e sistemit të adresave,tabelave dhe numrave,kodi(53736),.....	780.96 €
---	----------

Nën-programi Arsim fillor,mesëm i ulët (93000) në projektin:

“Furnizimi i shkollave me paisje të TIK-ut,kodi(49194)).....	2,740.17 €
---	------------

Nën-programi Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100) në projektet:

“Paisje speciale mjeksore mbi 1000”,kodi(49181).....	31,201.00 €
--	-------------

Nën-programi Shërbime Sociale(75501) në projektin:

“Veturë zyrtare për stafin e qendrës për punë sociale”,kodi(54135),.....	10,000.00 €
--	-------------

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga data e regjistrimit dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani



Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

A r s y e t i m

Dedikimi I këtyre mjeteve sipas nën-programeve dhe kategorive ekonomike është në pajtim me neni 6 të ligjit 08/L-332 të hyrat vetanake komunale nga arsimi dhe bashkëpagesat e kujdesit primar shëndetësor të cilat regjistrohen veçmas dhe si të tilla autorizohen dhe shfrytëzohen vetëm nga to. Bartjet e bilnaceve të pashpenzura të vitit paraprak ndahen në kategori ekonomike për mbulimin e obligimeve.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Arkivo - Archiv - Archive	
Dokument Org. Takt. Org. Takt.	02/2025 16080-2/2025
D. I. D. I. D. I. D. I. D. I. D. I. D. I. D. I. D. I.	16.06.2025 16.06.2025 16.06.2025
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarkuvja Lokalne Samoprave i Administracije Ministry of Local Government Administration	
Data Datum Date	16.06.2025
Organizimi Organizacija Organization	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Shënim Zaznaka Note	-VI-020-334/6

Për:	Ramiz Lladrovi, Kryetar i Komunës së Drenasit Bekim Lestrani, Kryesues i Kuvendit të Komunës	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela, Ud. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Avni Zogiani, Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Artan Ahmeti, Zëvendës i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Bora Duli, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Data: 04.06.2025
Zyrtarët përgjegjës:	Medina Millaku, Zyrtare e Lartë Ligjore për Hartim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Klmeta Zekaj, Udhëheqës e Divizionit për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Referencë: 91/2025
Lëndë:	Konfirmim i ligjshmërisë së akteve të Komunës së Drenasit	
Lloji i aktit:	Vendim	

Inderuari Kryetar z.Lladrovi,
Inderuar Kryesues z.Lestrani,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministriye, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendimi 02 Nr.400/01-19796 për bartjen e fondeve – të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025.</i>
<i>Vendimi 02 Nr.400/01-19793 për rrirjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 dhe bartjen në vitin 2025.</i>
<i>Të miratuar më datë 29.05.2025</i>
<i>Të parashtruara për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 29.05.2025</i>
<i>Të dërguara për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 02.06.2025</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Drenasit, jep konstatimet e mëposhtme:

1. Komuna e Drenasit, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, synon bartjen e fondeve – të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025 dhe rrirjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se proceset e mësipërme evidentohen edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP") dhe Ligjit 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.
3. Kështu, në kuptim të ndarjeve buxhetore komunale, neni 9, paragrafi 6 dhe 7 i Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025, përcakton se në rast se shuma e të hyrave vetanake të Komunës gjatë vitit i kalojnë shumat e të hyrave të ndara të asaj komune ato mjete bartin në vitin 2025, si në vijim:

Neni 9

Ndarja dhe ri-ndarja e fondeve të barta si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak

6. Bilançet e pasqepënuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2024 dhe vitet paraqike, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SHMFK si ndarje buxhetore për një-komunë, ndahen për vitin fiskal 2025 sipas autorizimeve të LMFPF-së.

7. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2024 dhe të regjistruara në SHMFK që kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1 për vitin 2024, bërtën në vitin 2025 në përputhje me vendimin e Kuvendit Komunal. Prforitet duhet të ketë ndarja e mjeteve për mbulimin e detyrimeve ekzistuese kontraktuale apo detyrimet që rrjedhin nga vendimet ghyqësore të formës së prerë.

4. Po ashtu, sipas nenit 27 të Ligjit 03-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ndarjet buxhetore që ndërliohen me të hyrat vetanake të pasqepënuara të komunës do të vëzhdojnë për komunën përkatëse në vitin e ardhshëm fiskal, si në vijim:

Neni 27

Skadimi i ndarjeve buxhetore në fund të viti fiskal

Të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal do të skadojnë në mesnatën e 31 Dhjetorit, me përjashtim të ndarjeve buxhetore të cilat ndërliohen me të ardhurat vetanake të pasqepënuara të komunave, apo të ndalojnë organizatat tjetër buxhetore të cilës i janë lëjuar me ligj, e të cilat bërtën në vitin vijues.

5. Nisur mbi premisat e këtij argumentimi, mbetet evidente se organizata ka bërë ndryshimin e planit të buxhetit për vitin 2025 dhe ka bërë bartjen e të hyrave vetanake të pasqepënuara nga viti fiskal 2024 duke rritur në këtë formë buxhetin nga këto të hyra. Përkundër kësaj, realizimi i suksesshëm i një procesi të tillë karakterizohet me detaje teknike buxhetore për të cilat organizatat buxhetore bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Buxhetit.
6. Në këtë kuptim, Ministria konstaton se ligjërisht, Komunave ju mundësohet që këto bilance të përdoren për të financuar edhe projekte të reja dhe ekzistuese në vitin aktual, mirëpo realizimi i suksesshëm i tyre kushtëzohet me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të leideve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.
7. Rrjedhimisht, aktet administrative të Komunës së Drenasit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi - me kusht që Komuna të bashkëpunojë ngushtë dhe të veprojë sipas udhëzimeve dhe/apo rekomandimeve të Departamentit të Buxhetit.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkthazi me këtë gëshije mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekën fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve